

LIGJI NR.08/L-072**PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL****Kuvendi i Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Miraton:

LIGJ PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të rregulloj hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural.
2. Ky ligj gjithashtu rregullon partneritetin me partnerë social dhe ekonomik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
3. Ky ligj është pjesërisht në pajtueshmëri me aktet e BE-së:
 - 3.1. Rregulloren (EU) nr. 1305/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi bujqësor evropian për zhvillim rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1698/2005;
 - 3.2. Rregulloren (EU) nr. 1307/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerët sipas skemave të mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 637/2008 dhe Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 73/2009;
 - 3.3. Rregulloren (EU) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore që shfuqizon rregulloret e Këshillit (EEC) nr. 352/78, (EC) nr. 165/94, (EC) nr. 2799/98, (EC) nr. 814/2000, (EC) nr.1290/2005 dhe (EC) nr. 485/2008;
 - 3.4. Rregulloren (EU) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që themelon organizatën e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (EEC) nr. 922/72, (EEC) nr. 234/79, (EC) nr. 1037/2001 dhe (EC) nr. 1234/2007;
 - 3.5. Rregulloren zbatuese të Komisionit (EE) nr.447/2014, të datës 2 maj 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (EU) br. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II);
 - 3.6. Direktivën 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 12 mars 2001, për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht që shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/220/EEC - Deklarata e Komisionit;
 - 3.7. Rregulloren (EU) nr.1144/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 22 tetor 2014, për masat e ofrimit dhe promovimit të informacionit në lidhje me produktet

bujqësore të zbatuara në tregun brendshëm dhe në vendet e treta dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 3/2008;

3.8. Rregulloren e Këshillit (EC) nr.834/2007 të datës 28 qershor 2007, për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike që shfuqizon Rregulloren (EEC) nr. 2092/91;

3.9. Rregulloren (EU) nr.1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore;

3.10. Rregulloren e Këshillit (EC) nr.1217/2009 të datës 30 nëntor 2009, për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit për të ardhurat dhe operimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për institucionet qendrore dhe lokale si dhe personat fizik dhe juridik të cilët mund të jenë përfitues nga përkrahja kombëtare dhe donatorët.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Aktivitet bujqësor** - nënkupton mbarështimin e kafshëve, kultivimin e bimëve, kërpudhave, me qëllim të prodhimit të ushqimit për njerëz dhe kafshë, prodhimin e fibrave, biokarburantëve, bimëve aromatike dhe prodhime të tjera për nevoja të njeriut;

1.2. **Pronë bujqësore** - nënkupton të gjitha njësitë që shfrytëzohen për aktivitete bujqësore dhe që menaxhohen nga fermeri, brenda territorit të Republikës së Kosovës;

1.3. **Prodhim bujqësor** - nënkupton prodhimtarinë nga kafshët dhe bimët;

1.4. **Produkt agroushqimor** - nënkupton prodhimet e përpunuara bujqësore dhe të rafinuara për treg;

1.5. **Fermer** - nënkupton personin fizik ose juridik, përgjegjës për menaxhimin e pronës bujqësore;

1.6. **Bujqësi e integruar** - nënkupton zbatimin e baraspeshuar të masave agroteknike duke u bazuar në faktorët ekonomikë, ekologjikë dhe toksikologjikë, ku në rast të efektit të njëjtë ekonomik, përparësi i jepet masave të cilat janë më të pranueshme nga aspekti ekologjik apo toksikologjik;

1.7. **Ministria** - nënkupton ministrinë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;

1.8. **Autoritet menaxhues** - nënkupton autoritetin administrativ në ministri, i cili është përgjegjës për përgatitjen e Strategjisë dhe Programit për bujqësi dhe zhvillim rural;

1.9. **Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - AZhB** - nënkupton autoritetin administrativ të përcaktuar në kuadër të ministrisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e masave të bujqësisë dhe zhvillimit rural;

1.10. **Politikë kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural** - nënkupton një tërësi masash ligjore dhe financiare që ndërmerr qeveria për ta mbështetur zhvillimin e

sektorit të bujqësisë dhe zhvillimin rural;

1.11. **Masa të financuara nga BE** - nënkupton instrumentet financiare për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural të financuara nga BE;

1.12. **Pagesë direkte** - nënkupton pagesat direkte për prodhuesit e produkteve bujqësore me qëllim stabilizimin e çmimeve të ushqimeve, sigurimin e prodhimit të mjaftueshëm të ushqimit, garantimin e të ardhurave themelore të fermerëve, ruajtjen e mjedisit dhe përgjithësisht forcimin e segmentit bujqësor të ekonomisë kombëtare;

1.13. **Zhvillim rural** - nënkupton përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të popullsisë në zonat rurale;

1.14. **Zonat më pak të favorizuara** - nënkupton zonën e papërshtatshme agroklimatike, me terren të vështirë për t'u arritur e për t'u punuar, siç është lartësia mbidetare dhe shpatijet, ku fermerët për shkak të vështirësive natyrore ballafaqohen me shpenzime shtesë për shfrytëzimin tyre;

1.15. **Shërbimi publik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural** - nënkupton politikat qeveritare në ofrimin e shërbimit nëpërmjet programeve të saj, më qëllim të avancimit të mëtejme të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

1.16. **Bujqësi organike** - nënkupton një sistem të përgjithshëm të menaxhimit të fermës dhe prodhimit të ushqimit që kombinon praktikat më të mira mjedisore, duke përdorur substanca dhe procese natyrore;

1.17. **Sigurim bujqësor** - nënkupton sigurimin e subvencionuar apo të pasubvencionuar të kulturave bujqësore, kafshëve, pylltarisë dhe kulturave ujore sipas këtij ligji;

1.18. **Siguruesi** - nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve të Ligjit përkatës për Sigurimet;

1.19. **SIAK**- nënkupton sistemin e integruar të administrimit dhe kontrollit;

1.20. **PPB** - nënkupton Politikën e Përbashkët Bujqësore;

1.21. **Vlerësimi ex ante** - nënkupton mjetin për të përmirësuar cilësinë e hartimit të programeve përmes vlerësimit të ndërlidhjes në mes të përshkrimit të situatës aktuale, mangësitë dhe potencialet për zhvillim, strategjinë për arritjen e objektivave, masat e identifikuar, buxhetin e alokuar dhe kapaciteteve implementuese për arritjen e qëllimit përfundimtar të atyre programeve;

1.22. **Kontrolli ex-post** - nënkupton kontrollin në terren të investimit pas zbatimit të projektit të bashkëfinancuar nga PZHR nëse projekti është duke ju përmbajtur kushteve të kontratës të lidhura në mes të Ministrisë dhe përfituesit;

1.23. **SWOT** - nënkupton përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet;

1.24. **LEADER** - nënkupton qasjen poshtë – lartë e cila është e lidhur me fuqizimin e qeverisjes lokale përmes zhvillimit të strategjive lokale e përbërë nga partneriteti publiko-privat;

1.25. **LPIS** - nënkupton sistemin e identifikimit të ngastrës së tokës;

- 1.26. **EMO** - nënkupton emërtimet e mbrojtura të origjinës;
- 1.27. **TMGj** - nënkupton treguesit e mbrojtur gjeografik;
- 1.28. **STG** – nënkupton Specialiteti tradicional i garantuar;
- 1.29. **RrDhKF** – nënkupton Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë;
- 1.30. **OMGj** - nënkupton organizmat e modifikuar gjenetikisht;
- 1.31. **Qeveria** - nënkupton qeverinë e Republikës së Kosovës;
- 1.32. **SKBZhR** - nënkupton Strategjia Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- 1.33. **PKBZhR** - nënkupton Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
- 1.34. **PZhR** - nënkupton Programi i Zhvillimit Rural;
- 1.35. **SPD** - nënkupton Skema e Pagesave Direkte;
- 1.36. **RrKZhR** - nënkupton Rrjeti Kombëtar për Zhvillim Rural;
- 1.37. **Ministri** - nënkupton Ministri i ministrisë përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;
- 1.38. **Komiteti monitorues** – nënkupton një organ kolektiv i cili ka për detyrë monitorimin e efikasitetit dhe efektivitetit të zbatimit të PBZhR-së dhe është i përberë prej institucioneve publike, private dhe organizatave joqeveritare të sektorit të agro-rural.

KAPITULLI II OBJEKTIVAT DHE PLANIFIKIMI I POLITIKËS PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 4 Objektivat e politikës për bujqësi dhe zhvillim rural

1. Me qëllim të adresimit të sfidave ekonomike, sociale dhe mjedisore në zonat bujqësore dhe rurale në Republikën e Kosovës, duhet të sigurohet korniza e politikave kombëtare në të cilën përcaktohen objektivat kryesore afatgjate të politikës bujqësore dhe zhvillimit rural, të cilat janë:

- 1.1. zhvillimi i një sektori konkurrues bujqësor dhe agrorshqimor me prodhim dhe produktivitet të rritur, të aftë për të prodhuar produkte të cilësisë së lartë që përmbushin kërkesat e tregut vendor, rajonal dhe të BE-së, duke kontribuar në sigurinë ushqimore me prodhim vendor më të lartë;
- 1.2. sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ushqim të sigurt dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorët;
- 1.3. mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisit nga efektet negative të prodhimit bujqësor, të cilat adresojnë sfidat e ndryshimeve klimatike, duke arritur përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe duke promovuar metodat e prodhimit të cilat e ruajnë mjedisin;
- 1.4. përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shtimi i mundësive të punësimit në zonat rurale duke nxitur punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e balancuar territorial të këtyre zonave.

Neni 5

Strategjia për zbatimin e politikës për bujqësi dhe zhvillim rural

1. Politika bujqësore e Republikës së Kosovës zbatohet përmes programeve: afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata të bujqësisë dhe zhvillimit rural.
2. Strategjia Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (më tutje SKBZhR) përcakton objektivat strategjike afatgjate dhe prioritetet e zhvillimit bujqësor dhe rural.
3. Strategjia Kombëtare për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duhet të jetë në harmoni me dokumentet e tjera strategjike.
4. SKBZhR-në e miraton Qeveria me propozim të Ministrisë për periudhën shtatë (7) vjeçare.

Neni 6

Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

1. Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (më tutje PKBZhR) e përbëjnë:
 - 1.1. Programi i Zhvillimit Rural (më tutje PZhR);
 - 1.2. Skema e Pagesave Direkte (më tutje SPD);
 - 1.3. masat tjera të mbështetjes publike për bujqësi.
2. Programi i zhvillimit rural përmban objektivat dhe prioritetet afatgjata, analizën e gjendjes aktuale, përshkrimin e masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural si dhe parimet bazë dhe instrumentet e zbatimit të masave të politikës, buxhetin indikativ shumëvjeçar dhe rezultatet e pritshme.
3. Skema e pagesave direkte përmbanë listën e prodhimeve bujqësore që do të subvencionohen gjatë periudhës së zbatimit të programit kombëtar, shumën maksimale të njësisë mbështetëse për pagesat direkte, kriteret bazë të pranueshmerisë për përfituesit dhe periudhën e aplikimeve për pagesat e dhëna direkte.
4. PKBZhR duhet të jetë në përputhje me SKBZhR-në dhe miratohet nga Qeveria me propozim të Ministrisë, për periudhën shtatë (7) vjeçare.
5. Ministria e monitoron zbatimin e SKBZhR-së dhe PKBZhR-së dhe propozon dhe arsyeton ndryshimet e tyre në përputhje me nevojat reale në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.
6. PKBZhR përcakton objektivat dhe prioritetet afatmesme për zhvillimin rural duke i përafuar me PPB të BE-së dhe përmban:
 - 6.1. analizën sektoriale të gjendjes aktuale në bujqësi dhe në zonat rurale;
 - 6.2. SWOT analizën e gjendjes si dhe identifikimin e nevojave;
 - 6.3. përshkrimin e strategjisë;
 - 6.4. përshkrimin e masave të përzgjedhura të zhvillimit rural;
 - 6.5. vlerësimin dhe planin e financimit të programit për bujqësi dhe zhvillimi rural;
 - 6.6. ndarjen e masave të financuara nga BE me masat e financuara nga burimet e tjera;

- 6.7. rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit ex-ante;
- 6.8. strukturën operative, menaxhuese dhe të kontrollit;
- 6.9. përshkrimin e procedurave të monitorimit dhe vlerësimit dhe përbërjen e Komitetit monitorues;
- 6.10. Rrjetin Kombëtar për Zhvillim Rural (më tutje RrKZhR) dhe përfshirjen e akterëve;
- 6.11. publicitetin, vizibilitetin si dhe shërbimet teknike dhe këshilluese.

Neni 7

Autoriteti menaxhues dhe Komiteti monitorues

1. Autoriteti Menaxhues është organ publik që vepron në nivel kombëtar, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e PKBZhR-së dhe masave të financuara nga BE, duke përfshirë përzgjedhjen e masave dhe publicitetin e tyre, koordinimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e tij.
2. Departamenti përgjegjës i politikave të zhvillimit rural është i caktuar ta kryej funksionin e Autoritetit menaxhues.
3. Përgjegjësia për monitorimin e PZhR-së ndahet ndërmjet Autoritetit Menaxhues dhe Komitetit monitorues, të themeluar për këtë qëllim. Komiteti monitorues është përgjegjës për monitorimin e efikasitetit dhe efektivitetit të zbatimit të PZhR-së.
4. Ministria me akt nënligjor i përcakton mënyrat dhe procedurat për kryerjen e aktiviteteve dhe detyrave nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, në pajtim me kërkesat e BE-së.

Neni 8

Zbatimi vjetor i programit kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural

1. Në bazë të Programit kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural, ministri miraton programin vjetor.
2. Programi vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni përmban masat që zbatohen për një (1) vit të caktuar kalendarik për t'i arritur objektivat e politikës bujqësore dhe ndahet në këto kategori:
 - 2.1. PZhR;
 - 2.2. SPD;
 - 2.3. masat e mbështetjes së tregut;
 - 2.4. masat tjera të mbështetjes publike për bujqësi dhe zhvillim rural.
3. Programi nga paragrafi 2 i këtij neni përmban:
 - 3.1. objektivat dhe arsyetimin e masave të zgjedhura;
 - 3.2. përfituesit e pranueshëm;
 - 3.3. kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes;

3.4. treguesit;

3.5. afatet dhe procedurat e aplikimit dhe zbatimit;

3.6. buxhetin në dispozicion.

4. Ministria miraton masat sipas paragrafit 2 të këtij neni, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga miratimi i buxhetit për vitin përkatës.

5. Ministria me akt nënligjor përcakton kriteret dhe procedurat e përkrahjes për masat e përcaktuara sipas paragrafit 2 të këtij neni.

KAPITULLI III MASAT DHE PARIMET E POLITIKËS PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 9

Parimet e përgjithshme në lidhje me masat e politikës bujqësore

1. Masat e politikës bujqësore duhet të zbatohen në bazë të kriterëve jodiskriminuesë dhe në përputhje me parimet e barazisë dhe efikasitetit.

2. Çdo dyfishim i masave duhet të shmangët me ndarje të qarta që lidhen me burimin e financimit nga burimet publike dhe të tjera.

Neni 10

Masat e politikës bujqësore

1. Masat e politikës bujqësore janë:

1.1. skemat e pagesave direkte;

1.2. masat e mbështetjes së tregut;

1.3. masat për zhvillim rural; dhe

1.4. masat e tjera të mbështetjes publike për bujqësi në nivel kombëtar, të cilat kontribuojnë në objektivat e politikës bujqësore të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji.

Neni 11

Masat në nivelin e njësive vendore për ta mbështetur politikën bujqësore

1. Me qëllim të zbatimit të rregullave të konkurrencës në tregun e brendshëm dhe trajtimit të barabartë të të gjithë fermerëve në Republikën e Kosovës, pagesat direkte dhe masat për organizimin e tregut nga neni 10 i këtij ligji, financohen dhe zbatohen ekskluzivisht në nivel kombëtar.

2. Komuna mund të bashkëfinancoj masa të caktuara të zhvillimit rural në pajtim me Programin për zhvillim rural dhe akteve nënligjore për zbatimin e këtyre masave.

3. Komuna mund të miratoj dhe zbatoj programe dhe masa të tjera të përkrahjes publike nga buxheti i tyre në bujqësi.

4. Masat e financuara nga komuna duhet të kenë ndarje të qartë nga masat e financuara nga Programi kombëtar.

Neni 12 **Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë**

1. Të gjitha masat e politikës bujqësore synojnë një zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë, i cili siguron shfrytëzim të qëndrueshëm dhe efikas të tokës, ruan dhe rrit biodiversitetin dhe mbron burimet natyrore dhe jetën në tokë, ujë dhe ajër.

2. Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë mbështetet në veçanti nga përdorimi ekologjik i burimeve natyrore, prodhimit të integruar në bujqësi, bujqësisë organike, zbatimit të projekteve të aplikuara hulumtuese dhe zhvillimore, bashkëpunimi me institucionet shkencore dhe krijimit të shërbimeve këshilluese.

Neni 13 **Pagesat direkte në bujqësi**

1. Pagesat direkte në bujqësi janë pagesa në baza vjetore për fermerët që merren me aktivitete bujqësore.

2. Zbatimi i skemave të pagesave direkte përcaktohet nga programet sipas neneve 6 dhe 8 të këtij ligji.

3. Pagesat direkte kontribuojnë në ndikimin mjedisor të prodhimit bujqësor, përmes praktikës së mirë.

4. Ministria me akt nënligjor i përcakton pagesat direkte dhe praktikat e mira bujqësore nga paragrafi 3 i këtij neni.

Neni 14 **Masat për organizimin e tregut**

1. Masat për organizimin e tregut janë:

1.1. Masat dhe rregullat për tregun e brendshëm:

1.1.1. masat intervenuese për ta stabilizuar tregun për produktet bujqësore;

1.1.2. standardet dhe rregullat e marketingut për vendosjen e produkteve në treg;

1.1.3. masat e ndihmës në sektorë të veçantë;

1.1.4. marrëdhëniet kontraktuale vullnetare dhe të detyrueshme në bujqësi.

1.2. Masat në tregtinë me vendet e tjera:

1.2.1. çertifikimi për import dhe eksport;

1.2.2. menaxhimi i kuotave tarifore.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton masat për organizimin e tregut nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 15 **Masat e zhvillimit rural**

1. Masat e zhvillimit rural kontribuojnë në rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe futjen e standardeve të reja në prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve

bujqësore dhe agroushqimore, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe peizazhit, diversifikimin e aktiviteteve në ekonominë rurale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale.

2. Masat e zhvillimit rural në Republikën e Kosovës i përcakton dhe zbaton Programi për zhvillim rural sipas nenit 6 të këtij ligji.

3. Gjatë hartimit të PZHR-së merren parasysh prioritetet dhe masat e politikës së BE-së për Zhvillim Rural.

4. Përgjatë hartimit nga paragrafi 2 i këtij neni, zbatimi i masave të zhvillimit rural të bashkëfinancuara nga buxheti i BE-së përcaktohet nga një dokument i veçantë në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit të BE-së.

5. Përgjatë hartimit nga paragrafi 2 i këtij neni përgatitja dhe zbatimi i Strategjive për zhvillim lokal, qasja LEADER përcaktohen me akt nënligjor nga ministria në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

6. Masat kombëtare të zhvillimit rural dhe masat e zhvillimit rural të financuara nga BE nuk duhet ta dyfishojnë njëra-tjetrën.

7. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret dhe procedurat e zbatimit për masat e zhvillimit rural.

Neni 16 Financimi

1. Masat e politikës bujqësore mund të financohen nga:

1.1. buxheti i Republikës së Kosovës;

1.2. donacionet ndërkombëtare;

1.3. fondet e BE-së; dhe

1.4. burimet e tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 17 Përfituesit

1. Përfituesi i masave të politikës bujqësore ose të zhvillimit rural është person fizik i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose person juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës, që zhvillon aktivitete në sferën e bujqësisë dhe/ose zhvillimit rural dhe i cili përfiton nga të drejtat dhe përmbush detyrimet e përcaktuara me këtë ligj.

2. Përfituesi i përdorë fondet e marra si mbështetje në kuadër të politikës zhvillimore bujqësore apo rurale, në pajtim me qëllimin për të cilin janë dhënë.

3. Përfituesi nga masat e politikës të zhvillimit rural do t'i nënshtrohet kontrollit ex-post gjatë periudhës pesë (5) vjeçare pas zbatimit të projektit dhe gjatë kësaj periudhe obligohet të ruajë dokumentet sipas të cilave ka përfituar.

4. Përfituesi i cili merr mbështetje në bazë të të dhënave të falsifikuara apo me mashtrim ose që nuk i përdorë ato për qëllimin për të cilin janë dhënë, obligohet ta kthejë shumën e përfituar në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe i njëjti do t'i nënshtrohet procedurave ligjore për mashtrim sipas ligjeve në fuqi.

5. Ministria çdo vit publikon listën e përfituesve që përfshin, masën, shumën dhe informatat tjera relevante për përfituesit.

6. Përfituesi e përdorë mbështetjen financiare nga Ministria ashtu siç është përcaktuar me kontratë.

KAPITULLI IV ZBATIMI I MASAVE TË POLITIKËS PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 18 Agjencia për zhvillimin e bujqësisë

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (më tutje AZhB) kryen funksionin e Agjencisë së pagesave dhe është përgjegjëse për zbatimin e masave për bujqësi dhe zhvillim rural.
2. AZhB, përveç detyrave që dalin nga zbatimi i paragrafit 1 të këtij neni, në mënyrë të veçantë:
 - 2.1. përgatit dhe publikon thirrje për aplikim për mbështetje publike;
 - 2.2. pranon, kontrollon dhe procedon aplikacionet e përfituesve;
 - 2.3. merr vendime dhe lidhë kontrata që përmbajnë të drejtat dhe obligimet e përfituesve;
 - 2.4. i aprovon dhe i kryen pagesat;
 - 2.5. e shqyrton dokumentacionin administrativ dhe kryen kontrolle në terren;
 - 2.6. e ruan dhe menaxhon bazën e të dhënave dhe regjistrat për të cilët është përgjegjëse AZhB-ja, në pajtim me aktet nënligjore;
 - 2.7. kryen aktivitete të tjera të përcaktuara me akte nënligjore nga zbatimi i paragrafit 5 të këtij neni.
3. AZhB zbaton programe mbështetëse ndërkombëtare në bujqësi dhe zhvillim rural përveç nëse autorizohet një institucion tjetër publik për zbatimin e programeve mbështetëse sipas aktit të veçantë ligjor.
4. AZhB mund të delegojë kompetenca të caktuara për zbatimin e masave nga neni 10 i këtij ligji, tek trupat deleguese përmes kontratës me shkrim. Në asnjë rast nuk mund të delegohen procesi i selektimit dhe kontraktimit të përfituesve, përlllogaritjes, zotimet dhe ekzekutimit të pagesave.
5. Për qëllimet e këtij neni, trupat deleguese nënkupton, institucionet tjera tek të cilat AZhB delegon kompetenca të përcaktuara sipas paragrafit 4 të këtij neni.
6. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet dhe kriteret për delegimin e kompetencave nga paragrafi 4 i këtij neni.
7. Detyrat e AZhB-së në lidhje me miratimin, kontraktimin dhe pagesën e projekteve të financuara nga BE duhet të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

Neni 19 Sistemi i integruar i administrimit dhe kontrollit

1. AZhB themelon dhe funksionalizon Sistemin e integruar të administrimit dhe kontrollit (SIK) me qëllim të zbatimit të menaxhimit dhe kontrollit të pagesave për zhvillim rural dhe pagesave direkte.

2. SIAK nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:

2.1. Regjistrin e fermerëve;

2.2. Sistemin e identifikimit të ngastrave të tokës (LPIS);

2.3. Regjistrin e pagesave direkte i cili përfshin sistemin për identifikimin unik të fermerëve dhe menaxhimin e pagesave direkte prej momentit të aplikimit deri tek përpilimi i listave për pagesë;

2.4. Regjistrin e granteve i cili përmban aplikimin për grante, kërkesën për pagesë, vlerësimin, miratimin, kontraktimin dhe kontrollet të detyrueshme në terren, të cilat përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi;

2.5. Regjistrin për menaxhimin e borxhit i cili përfshin listën e zezë të fermerëve dhe borgjet financiare që duhet t'i kthej;

2.6. Regjistri i menaxhimit të dokumenteve përfshin menaxhimin e të gjitha dokumenteve në AZhB;

2.7. Regjistrin e përfituesve në AZhB i cili përfshin që të gjitha regjistratë e pagesave për fermerët për grante dhe subvencione;

2.8. Regjistrin për mbështetjen e treguesve.

3. Zhvillimi i regjistrave të tjerë të nevojshëm për themelimin e SIAK.

3.1. ndërlidhja e regjistrave të AZhB-së me të gjithë regjistrat e nevojshëm për shkëmbim të të dhënave me të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.

4. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet dhe mënyrën e mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë dhe procedurat administrative të SIAK.

KAPITULLI V MASAT TJERA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 20 Masat e politikës së tokës

1. Masat e politikës së tokës përfshijnë masat që synojnë menaxhimin më të mirë të tokës përmes rregullimit të tokës dhe masave të tjera të ngjashme që lidhen me përmirësimin e statusit ligjor, përdorimin më efikas të tokës dhe masat për përmirësimin e mbrojtjes dhe cilësisë së tokës.

2. Masat për përmirësimin e mbrojtjes dhe cilësisë së tokës bujqësore nënkuptojnë llojin e nxitësve të cilët përmirësojnë karakteristikat fizike, kimike dhe biologjike të tokës.

3. Ministria me akt nënligjor i përcakton masat e politikës së tokës sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 21 Masat e menaxhimit të rrezikut në bujqësi dhe restaurimit të potencialit të prodhimit bujqësor

1. Masat e menaxhimit të rrezikut në bujqësi dhe restaurimit të potencialit të prodhimit bujqësor

përfshijnë:

- 1.1. sigurimin e kulturave bujqësore, kafshëve, pylltarisë dhe kulturave ujore;
 - 1.2. restaurimin e potencialit të prodhimit bujqësor të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet katastrofale.
2. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni programohen dhe financohen nga buxheti kombëtar dhe në pajtim me Programin e zhvillimit rural nga neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i këtij ligji mund të financohen edhe nga burime të tjera financiare në bazë të kriterëve të njëjta të pranueshmërisë nga Programi i zhvillimit rural dhe aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e këtij programi.
3. Mbështetja publike ndaj fermerëve nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i këtij neni, mbulon kontributet financiare në primet për sigurimin e kulturave bujqësore, pylltarisë, kafshëve dhe kulturave ujore kundër humbjeve ekonomike të fermerëve të shkaktuara nga moti i keq, sëmundjet e kafshëve ose të bimëve ose nga një aksident mjedisor.
4. Sigurimi nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të këtij neni siguron në bazë të produkteve të sigurimit standard.
5. Ministria me akt nënligjor përcakton detyrimet e përfituesve që marrin pjesë në një skemë të caktuar të sigurimit dhe aplikojnë për mbështetje publike, shkalla e mbështetjes, kriteret e pranueshmërisë dhe hollësi të tjera të zbatimit.
6. Mbështetja publike për fermerët ose grupe fermerësh në kuadër të paragrafit 1, nënparagrafit 1.2 të këtij neni përfshinë:
- 6.1. investimet në veprime parandaluese me qëllim të zvogëlimit të pasojave nga fatkeqësitë e mundshme natyrore dhe ngjarjeve katastrofale;
 - 6.2. investimet për restaurimin e tokës bujqësore dhe të potencialit të prodhimit të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjet katastrofale.
7. Mbështetja sipas paragrafit 6, nënparagrafi 6.2. të këtij neni bëhet në përputhje me pranimin formal të autoriteteve përgjegjëse publike në Republikën e Kosovës që ka ndodhur një katastrofë natyrore dhe masat për të kontrolluar ose eliminuar këtë katastrofë natyrore.
8. Ministria siguron që të shmanget mbikompensimi si rezultat i kombinimit të masave nga paragrafi 1 i këtij neni dhe instrumenteve të tjera të mbështetjes kombëtare ose skemave private të sigurimit.
9. Ministria me akt nënligjor përcakton detyrimet e përfituesve potencial të cilët mund të preken nga katastrofat natyrore, moti i keq dhe ngjarjet katastrofale dhe të cilët aplikojnë për mbështetje publike, shkallët e mbështetjes sipas paragrafit 6 nënparagrafi 6.2. të këtij neni dhe hollësi të tjera të zbatimit.
10. Përveç kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga katastrofat natyrore në bujqësi të përcaktuara nga paragrafi 9 i këtij neni, varësisht prej kushteve dhe rrethanave të krijuara dhe mundësive të lejuara buxhetore për vitin përkatës, Ministria me akt nënligjor mund të përcaktoj kompensimin e dëmeve natyrore në bujqësi që mund të jenë të shkaktuar nga moti i keq, vërshimet, breshëri, bora, ngricat, erërat e forta dhe zjarri fushor.

Neni 22

Masat e informimit dhe promovimit

1. Qeveria prezanton një sistem të masave të informimit dhe promovimit për disa produkte bujqësore dhe ushqimore me origjinë vendore të pranishme në tregun e brendshëm apo për eksport.
2. Masat e informimit dhe promovimit nga paragrafi 1 i këtij neni, në mënyrë të veçantë kontribuojnë në:
 - 2.1. ndërgjegjësimin e konsumatorëve në lidhje me cilësinë produkteve dhe njohjen e tyre në tregjet e brendshme dhe të jashtme;
 - 2.2. rritjen e konkurrencës dhe konsumit të produkteve bujqësore dhe ushqimore;
 - 2.3. rivendosjen e kushteve normale të tregut në rast të çrregullimit serioz të tregut, humbjes së besimit të konsumatorit apo problemeve të tjera të veçanta.
3. Masat e informimit dhe promovimit zbatohen në bazë të programeve të aprovuara nga ministri.
4. Programet nga paragrafi 3 i këtij neni i propozojnë organizatat prodhuese të regjistruara në Republikën e Kosovës. Programet mund t'i propozojnë edhe organet dhe personat e tjerë juridik nga sektori agroushqimor të cilët ofrojnë informacione në lidhje me produktet bujqësore.
5. Ministria me akt nënligjor përcakton detyrimet e subjekteve juridike nga paragrafi 4 i këtij neni, mënyrat dhe kohëzgjatjen e programeve të informimit dhe promovimit, financimin e masave të informimit dhe promovimit, produktet e pranueshme si dhe detaje të tjera të zbatimit.

Neni 23

Organizatave të prodhuesëve

1. Në bazë të kërkesës së organizatave prodhuese, ministria duhet t'i njohë ato të cilat:
 - 1.1. krijohen dhe kontrollohen nga prodhuesit e një sektori të veçantë bujqësor;
 - 1.2. formohen me iniciativën e prodhuesve;
 - 1.3. kanë një numër minimal të anëtarëve dhe mbulojnë një vëllim apo vlerë minimale të prodhimit të tregtueshëm;
 - 1.4. ndjekin një qëllim të veçantë i cili mund të përfshijë një ose më shumë nga objektivat si në vijim:
 - 1.4.1. sigurimin që prodhimi është planifikuar dhe rregulluar sipas kërkesës, veçanërisht sa i përket cilësisë, sasisë dhe kërkesave të qasjes në treg;
 - 1.4.2. përqëndrimin e furnizimit dhe vendosjen në treg të produkteve të prodhuara nga anëtarët e saj, përfshirë edhe përgatitjen për shitje;
 - 1.4.3. optimalizimin e kostove të prodhimit dhe stabilizimin e çmimeve të prodhuesëve;
 - 1.4.4. zhvillimin e aftësive të biznesit dhe marketingut si dhe organizimin dhe lehtësimin e proceseve të inovacionit.
2. Mbështetja publike sipas nenit 6 të këtij ligji mund t'i jepet organizatave të prodhuesëve për

ta lehtësuar themelimin dhe aktivitetet e tyre në treg.

3. Mbështetja nga paragrafi 2 i këtij neni jepet për organizatat prodhuese të cilat janë të njohura zyrtarisht nga ministria në bazë të planit të biznesit dhe të cilat përmbushin kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni.

4. Sektori i pranueshëm nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, kriteret nga nënparagrafi 1.3, formati i planit të biznesit nga paragrafi 3 i këtij neni dhe kriteret tjera teknike të cilat duhet t'i përmbushin organizatat e prodhuesëve në mënyrë që të përfitojnë mbështetje përcaktohen me akt nënligjor nga ministria.

Neni 24

Shitja e produkteve të fermerëve

1. Shitja e produkteve të fermerëve të prodhuara në pronat e tyre bujqësore ka të bëjë me:

1.1. shitjen me shumicë për personat e regjistruar fizik ose juridik të cilët blejnë produkte bujqësore për përpunim ose shitje të mëtejshme;

1.2. shitjen direkte në pronat ose vendet e shitjes me pakicë, përveç në dyqane.

2. Ministria me akt nënligjor përcakton mënyrat dhe kushtet për shitjen e prodhimeve të fermerëve nga paragrafi 1 i këtij neni dhe dëshmitë që duhet të mbahen nga fermeri.

Neni 25

Aktivitetet dytësore në pronat bujqësore

1. Aktivitetet dytësore në pronat bujqësore janë aktivitetet e lidhura me bujqësinë të cilat ofrojnë të ardhura shtesë dhe lehtësojnë shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese dhe të punës së anëtarëve të pronës bujqësore.

2. Ministria me akt nënligjor i përcakton llojet dhe kushtet për aktivitete dytësore në pronat bujqësore.

KAPITULLI VI

BUJQËSIA E INTEGRUAR DHE PRODHIMI ORGANIK

Neni 26

Bujqësia e integruar

1. Fermerët e përfshirë në sistemin e bujqësisë së integruar i zbatojnë masat agroteknike të përcaktuara me udhëzues.

2. Ministria i përgatitë udhëzuesit agroteknik nga paragrafi 1 i këtij neni për fusha të veçanta të prodhimit të integruar.

3. Organizmat e modifikuar gjenetikiisht (OMGj), produktet që dalin nga ato dhe produktet që përmbajnë OMGj ose produktet e tyre nuk përdoren në bujqësinë e integruar.

4. Ministria me akt nënligjor përcakton inspektimin dhe kontrollin e bujqësisë së integruar që kryhet nga shërbimet publike.

Neni 27 **Prodhimi organik**

1. Objektivat e prodhimit organik janë:

1.1. Krijimi i sistemit të qëndrueshëm të menaxhimit në bujqësi, i cili:

1.1.1. respekton sistemet dhe ciklet e natyrës si dhe mbështet dhe rritë shëndetin e tokës, ujit, bimëve dhe kafshëve si dhe ekuilibrin ndërmjet tyre;

1.1.2. i kontribuon nivelit të lartë të diversitetit biologjik;

1.1.3. bën përdorim të përgjegjshëm të energjisë dhe burimeve natyrore, si, uji, toka, lëndët organike dhe ajri;

1.1.4. i zbaton standardet e larta të mirëqenies së kafshëve dhe në veçanti i plotëson nevojat e sjelljeve specifike të llojeve të kafshëve;

1.2. Synimi i prodhimit të produkteve të kualitetit të lartë;

1.3. Synimi i prodhimit të ushqimeve të shumëllojshme dhe produkteve të tjera bujqësore që i përgjigjen kërkesës së konsumatorëve për mallrat e prodhuara nga përdorimi i proceseve që nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin e njeriut, shëndetin e bimëve apo shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

2. OMGj-të dhe produktet e prodhuara nga OMGj-të nuk përdoren si ushqim për njerëz, ushqim për kafshë, mjete ndihmëse të përpunimit, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehra, përpunues të tokës, farëra, material shtues vegjetativ, mikroorganizma dhe kafshë në prodhimin organik.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton prodhimin organik, duke përfshirë parimet, rregullat e prodhimit, kontrollin, etiketimin dhe kushtet për fermat organike.

KAPITULLI VII **STANDARDET E CILËSISË DHE MARKETINGUT SI DHE SKEMAT E CILËSISË PËR** **PRODUKTET BUJQËSORE DHE PRODUKTET USHQIMORE**

Neni 28 **Fusha e zbatimit dhe fushëveprimi i produkteve**

1. Ministria përcakton rregulla shtesë, në sektorin veterinar, fitosanitar dhe ushqimor për të siguruar që produktet janë në pajtim me standardet e higjienës dhe të shëndetit dhe për ta mbrojtur shëndetin e njeriut, kafshëve dhe bimëve.

2. Rregullat nga paragrafi 1 i këtij neni, ndahen ndërmjet rregullave të detyrueshme dhe skemave jo të detyrueshme të cilësisë dhe kushteve të rezervuara për produktet bujqësore dhe ushqimore.

3. Produktet për të cilat zbatohen rregullat e detyrueshme dhe jo të detyrueshme shtesë në lidhje me standardet e cilësisë dhe marketingut nga paragrafi 2 i këtij neni përfshijnë ushqimin për kafshë.

4. Rregullat e detyrueshme në lidhje me standardet e cilësisë dhe marketingut zbatohen për të gjitha produktet të cilat janë të vendosura në tregun e Republikës së Kosovës dhe që eksportohen në tregjet e tjera nga Republika e Kosovës.

5. Rregullat jo të detyrueshme shtesë në lidhje me skemat e cilësisë dhe kushtet e rezervuara për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore janë vullnetare dhe zbatohen vetëm për produktet që prodhohen dhe janë me origjinë nga Republika e Kosovës.

Neni 29

Standardet e cilësisë dhe marketingut për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore

1. Standardet e cilësisë së marketingut për produktet bujqësore dhe ushqimore përfshijnë klasifikimin, kategorizimin, emërtimin, përbërjen e tyre fizike, kimike, karakteristikat shqisore, llojin, sasinë e lëndëve të para, aditivëve e substancave të tjera të përdorura në prodhimin, përpunimin e produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore si dhe kërkesat shtesë për efikasitetin e këtyre produkteve.
2. Për produkte të caktuara bujqësore dhe produkte ushqimore, standardet e cilësisë dhe marketingut përfshijnë procedurat që duhet të zbatohen para vendosjes së produktit në treg ose kushte të tjera, përfshirë procedurat e lejuara teknologjike.
3. Operatorët ushqimor nuk lejohen t'i vendosin në treg produktet që nuk përputhen me standardet e cilësisë dhe marketingut nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.
4. Ministria me akt nënligjor përcakton standardet e cilësisë dhe marketingut nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, fushëveprimin e produkteve dhe metodat e kontrollit për përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore me standardet përkatëse.

Neni 30

Skemat e cilësisë për prodhimet bujqësore dhe produktet ushqimore

1. Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të produkteve me karakteristika të veçanta që ndërlidhen me origjinën e tyre gjeografike si dhe produkteve tradicionale në Republikën e Kosovës, ministria krijon skema të cilësisë në nivel kombëtar me përdorimin e logos së mbrojtur bazuar në skemat e cilësisë në Bashkimin Evropian.
2. Skemat e cilësisë nga paragrafi 1 i këtij neni janë si vijon:
 - 2.1. Emërtimet e mbrojtura të origjinës (EMO) – EMO-ja identifikon produktet që prodhohen, përpunohen dhe përgatiten në një zonë të caktuar gjeografike të Republikës së Kosovës, duke shfrytëzuar njohuritë e prodhuesve vendor si dhe përbërësit nga zona gjeografike në fjalë;
 - 2.2. Treguesit e mbrojtur gjeografik (TMGj) – TMGj-ja identifikon produktet cilësia ose reputacioni i të cilave është i lidhur me vendin ose rajonin në Republikën e Kosovës, ku është prodhuar, përpunuar apo përgatitur, dhe përbërësit e shfrytëzuar nuk duhet të jenë medoemos me origjinë nga ajo zonë gjeografike.
 - 2.3. Specialiteti tradicional i garantuar (STG) - STG-ja identifikon produktet me karakter tradicional, qoftë në përbërje apo mjete të prodhimit apo receta tradicionale, pa një lidhje të veçantë me një zonë të caktuar gjeografike;
 - 2.4. Të gjitha produktet EMO, TMGj dhe STG duhet t'i përmbahen një grupi të specifikimeve dhe mund të mbajnë logon specifike të përcaktuar dhe të miratuar nga ministri.
3. Përjashtimisht nga skemat e cilësisë nga paragrafi 1 i këtij neni, ministria sipas nevojës krijon skema të tjera vullnetare të cilësisë dhe kushte të rezervuara për prodhime bujqësore dhe produkte ushqimore në nivel kombëtar, me qëllim të asistimit të fermerëve në komunikimin më të mirë të karakteristikave me vlerë të shtuar apo attributeve të prodhimeve të tyre në tregun kombëtar.

4. Skemat vullnetare të cilësisë dhe kushtet e rezervuara nga paragrafi 3 i këtij neni përfshijnë një ose më shumë nga kushtet si në vijim: produkt malor, produkt i bujqësisë lokale, shitje e drejtpërdrejtë, skemat tjera të veçanta vullnetare të cilësisë dhe kushtet e rezervuara të propozuara nga prodhuesit.

5. Ministria me akt nënligjor përcakton krijimin dhe zbatimin e skemave të cilësisë dhe kushteve të rezervuara nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, fushëveprimin e produkteve, kërkesën e përfituesit të mundshëm dhe metodat e kontrollit për përputhshmëri me karakteristikat përkatëse dhe kërkesat e përcaktuara me këto skema.

Neni 31

Dhurimi i ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë

1. Dispozitat e këtij neni rregullojnë sistemin e dhurimit të ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë me qëllim të zvogëlimit të humbjeve masive të ushqimit, ruajtjes së mjedisit dhe me qëllim që të ndihmohen përdoruesit përfundimtarë.

2. Mund të dhurohet vetëm ushqimi për njerëz dhe ushqimi për kafshë i cili i plotëson të gjitha kërkesat e sigurisë ushqimore në pajtim me rregulloret kombëtare.

3. Operatorët e ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë që marrin pjesë në zinxhirin e dhurimit duhet të sigurojnë që ushqimi për njerëz dhe ushqimi për kafshë që dhurohet i plotëson të gjitha kërkesat e sigurisë ushqimore në fazën e kontrollimit - prodhimi, përpunimi, ruajtja, transporti, shpërndarja dhe përgatitja.

4. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë mbikëqyrë Regjistrin e ndërmjetësve në zinxhirin e dhurimit të ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë.

5. Ministria me akt nënligjor i përcakton kërkesat e detajuara, kriteret dhe metodat e dhurimit të ushqimit për njerëz dhe ushqimit për kafshë, kushtet që ndërmjetësi në dhurimin e ushqimit duhet t'i përmbushë, përmbajtjen dhe metodën e mbajtjes së regjistrit.

KAPITULLI VIII

BAZA E TË DHËNAVE DHE REGJISTRAT NË BUJQËSI

Neni 32

Baza e të dhënave dhe regjistrat në bujqësi

1. Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të masave të caktuara të politikës bujqësore, ministria krijon bazën e të dhënave dhe regjistrat si në vijim:

1.1. Regjistrat dhe baza e të dhënave përmbajnë këto të dhëna:

1.1.1. Regjistri i fermës;

1.1.2. Regjistri i prodhuesëve dhe përpunuesëve të produkteve bujqësore dhe ushqimore;

1.1.3. Regjistri i shfrytëzimit të tokës bujqësore (LPIS);

1.1.4. Regjistri për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve;

1.1.5. Regjistri i përfituesëve;

1.1.6. Regjistri i prodhuesëve në bujqësinë e integruar;

1.1.7. Regjistri i prodhuesëve në prodhimin organik;

1.1.8. Regjistri i tregtarëve dhe importuesëve të produkteve të caktuara bujqësore;

1.1.9. Baza e të dhënave të Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit në Fermë (RrDhKF);

1.1.10. Baza e të dhënave për çmimet e tregut të produkteve të caktuara bujqësore;

1.1.11. Baza e të dhënave të produkteve bujqësore në skemat e cilësisë;

1.1.12. Baza e të dhënave për ndihmat shtetërore në bujqësi.

2. Bazat e të dhënave të cilat nuk përmbajnë të dhëna personale:

2.1. Baza e të dhënave për zonat më pak të favorizuara;

2.2. Bazat e të dhënave të tjera;

2.3. Bazat e të dhënave me funksion për mundësimin e ndërveprimit të të dhënave nga sisteme të ndryshme.

3. Të dhënat e përfshira në regjistrat nga nënparagrafi 1.1 i këtij neni janë publike, me përjashtim të të dhënave dhe informacioneve personale të cilat konsiderohen konfidenciale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Të dhënat dhe informacionet personale të cilat konsiderohen konfidenciale të biznesit ose tatimore duhet të përdoren vetëm për qëllime për të cilat janë grumbulluar.

5. Ministria mund të delegojë kompetenca të caktuara në zbatimin dhe menaxhimin e bazave të të dhënave të caktuara dhe regjistrave nga paragrafi 1 i këtij neni tek institucionet tjera publike.

6. Ministria me akt nënligjor përcakton krijimin, përmbajtjen, kushtet për regjistrim dhe procedurat e hollësishme në lidhje me menaxhimin, mbajtjen e shënimeve dhe shfrytëzimin e të dhënave nga bazat e të dhënave dhe regjistrat.

Neni 33 Regjistri i fermës

1. Regjistrimi në regjistrin e fermës është vullnetar.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, regjistrimi në regjistrin e fermës është i detyrueshëm për:

2.1. Fermerët që aplikojnë për masa të politikës bujqësore nga neni 10 i këtij ligji;

2.2. Fermerët të cilët shesin në treg produkte të cilat janë prodhuar në pronat e tyre bujqësore.

3. Ministria zhvillon procedurat e kontrollit të regjistrimit të fermerëve në regjistrin e fermës dhe vendos për pranimin ose refuzimin e regjistrimit.

4. Të dhënat nga regjistri i fermës përdoren për aplikimin dhe kontrollin e mbështetjes financiare

dhe mbështetje të tjera për përfituesit e masave të përcaktuara me nenin 10 të këtij ligji.

5. Ministria me akt nënligjor përcakton krijimin, përmbajtjen, kushtet për regjistrim dhe mënyrën e ruajtjes së shënimeve dhe shfrytëzimit të të dhënave nga regjistri i fermës.

KAPITULLI IX HULUMTIMI, ARSIMIMI DHE TRAJNIMI PROFESIONAL NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 34 Hulumtimi bujqësor

1. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat shkencore të tyre, mund të bashkëfinancojë hulumtimet e projekteve zhvillimore për bujqësi dhe zhvillim rural si dhe zhvillim të infrastrukturës përkatëse.

2. Ministria do të themeloj Këshillin për hulumtime të aplikuara në bujqësi (në tekstin e mëtejme Këshilli) për zbatimin e projekteve.

3. Këshilli përbëhet nga përfaqësuesit si në vijim:

3.1. Ministria - dy (2) anëtarë, njëri anëtar është kryetar i Këshillit;

3.2. Ministria përgjegjëse për shkencë dhe arsim - një (1) anëtar;

3.3. Fermerët - tre (3) anëtarë nga rajone dhe sektorë të ndryshëm të bujqësisë;

3.4. Institucionet akademike nga shkencat përkatëse - tre (3) anëtarë;

3.5. Instituti Bujqësor i Kosovës - një (1) anëtar;

3.6. Shërbimi Këshillimor - një (1) anëtar.

4. Projektet hulumtuese zhvillimore nga Këshilli financohen nga pjesa e buxhetit të shtetit të ndarë për ministrinë, të cilat mund të përfshijnë fonde nga donatorët ndërkombëtarë dhe bashkëfinancim nga përfituesit e projekteve hulumtuese.

5. Ministri me vendim emëron anëtarët e Këshillit për një periudhë prej tri (3) vitesh. Një (1) anëtar mund të emërohet më së shumti për dy (2) mandate.

6. Ministri miraton rregulloren e punës së Këshillit dhe përcakton prioritetet vjetore për programin e hulumtimit të aplikuar si dhe kriteret për aplikimin dhe zbatimin e programit.

Neni 35 Arsimimi dhe aftësimi profesional

1. Ministria ndërmerr iniciativa të ndryshme të arsimimit dhe aftësimit profesional për nevojat e bujqësisë, agroindustrisë dhe zhvillimit rural në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet tjera arsimore të specializuara në bujqësi, si dhe me shërbimin këshillimor dhe institucionet e tjera publike në fushën e bujqësisë.

2. Ministria mund të bashkëfinancojë arsimimin dhe aftësimin profesional si dhe iniciativat për sigurimin e pajisjeve për zbatimin praktik të arsimimit dhe aftësimit profesional për nevojat e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

3. Përfituesit e arsimit dhe aftësisë profesionale nga paragrafi 2 i këtij neni janë fermerët, punonjësit dhe specialistët e bujqësisë dhe agroindustrisë.
4. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet e detajuara dhe kriteret për bashkëfinancimin dhe zbatimin e aktiviteteve nga paragrafi 2 i këtij neni.

KAPITULLI X MONITORIMI DHE RAPORTIMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 36 Raporti i gjelbër

1. Ministria harton dhe miraton Raportin e gjelbër që pasqyron zhvillimin vjetor, analizën e ndryshimeve strukturore dhe gjendjen ekonomike të bujqësisë. Ky raport finalizohet deri më 20 dhjetor të vitit aktual për gjendjen e vitit paraprak.
2. Raporti i gjelbër analizon gjendjen ekonomike të ekonomive bujqësore sipas llojeve dhe madhësisë së fermave duke marrë parasysh fermat në RrDhKF nga neni 38 i këtij ligji, marrëdhëniet ndërmjet bujqësisë dhe ambientit të përgjithshëm ekonomik, zhvillimet e prodhimit bujqësor dhe përdorimi i tyre, përdorimi i tokës bujqësore, pylltarinë, konsumin, çmimet e tregut të prodhimeve bujqësore, tregtinë e jashtme, sigurinë dhe cilësinë e ushqimit. Raporti i gjelbër poashtu pasqyron politikat bujqësore; pagesat direkte në bujqësi dhe përkrahjen e zhvillimit rural si dhe politika tjera mbështetëse.
3. Raporti i gjelbër bazohet në analizimin e të dhënave zyrtare nga statistikat bujqësore si dhe të të dhënave tjera zyrtare në dispozicion.
4. Raporti i gjelbër pas miratimit publikohet në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë.

Neni 37 Sistemi i informacionit për çmimet e tregut

1. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e sistemit informativ për çmimet e tregut të inputeve, prodhimeve, produkteve, makinerive bujqësore si dhe çmimeve të prodhimeve dhe produkteve bujqësore në nivel ferme.
2. Çmimet e tregut të produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni mblidhen në tregjet përfaqësuese nga personat e zgjedhur fizik dhe juridik.
3. Çmimet në nivel të fermës të prodhimeve dhe produkteve nga paragrafi 1 i këtij neni mblidhen direkt në fermë nga personat e zgjedhur fizik dhe juridik.
4. Ministria me akt nënligjor përcakton mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për çmimet e inputeve, prodhimeve, produkteve bujqësore dhe makinerive bujqësore si dhe tregjet përfaqësuese.

Neni 38 Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë

1. Ministria është përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë (RrDhKF).
2. RrDhKF është sistem që përdoret për vlersimin e të ardhurave të fermës, vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fermës dhe ndikimin e politikave në strukturën dhe performancën e fermës.
3. Pjesëmarrja e fermës bujqësore në Rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në fermë (RrDhKF)

është në baza vullnetare.

4. Ministria me akt nënligjor, përcakton mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave të RrDhKF-së.

5. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret për përcaktimin e fermave që janë pjesë e RrDhKF-së.

Neni 39 Studimet analitike dhe zhvillimore

1. Për qëllime të planifikimit, monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit të ndikimit të masave dhe instrumenteve në lidhje me objektivat e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, ministria do të kryejë studime analitike dhe zhvillimore në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe strukturat tjera të specializuara.

2. Studimet analitike dhe zhvillimore në veçanti fokusohen në:

2.1. vlerësimin e ndikimit të masave të ndërmarra nga qeveria me qëllim të zhvillimit të sektorit agrorural;

2.2. realizimin e analizave ekonomike dhe analizave të tjera me ndikim në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agroindustrisë;

2.3. realizimin e analizave dhe aktiviteteve të planifikuara në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agroindustrisë;

2.4. përmbushjen e përgjegjësive të rëndësishme për trajnimin dhe mbikëqyrjen e çështjeve zhvillimore në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe agroindustrisë.

KAPITULLI XI MBËSHTETJA INSTITUCIONALE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 40 Fushat e shërbimeve publike

1. Mbështetja institucionale në fushën e bujqësisë ofrohet përmes shërbimeve të ndryshme publike:

1.1. Shërbimet këshillimore në bujqësi dhe zhvillim rural;

1.2. Shërbimet në lidhje me ushqimin dhe sigurinë e ushqimit, shëndetin e bimëve dhe kafshëve;

1.3. Shërbimet në lidhje me hulumtimet bujqësore dhe analizat laboratorike;

1.4. Shërbimet në lidhje me materialin fidanor dhe farërat;

1.5. Shërbimet e ruajtjes së racës dhe varieteteve në bujqësi;

1.6. Shërbimet në lidhje me tokën bujqësore dhe ujitjen;

1.7. Shërbimet e infrastrukturës së tregut dhe marketingut.

2. Qeveria mund të mbështet edhe shërbime të tjera të specializuara publike në bujqësi.

Neni 41 **Detyrimet e shërbimit publik**

1. Shërbimet publike në bujqësi dhe zhvillim rural përfshijnë:
 - 1.1. realizimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë të aktivitetit të shërbimit të përcaktuar;
 - 1.2. realizimin e këtij shërbimi për çdo fermer, grup fermerësh, person fizik apo juridik të angazhuar në aktivitetin bujqësor në pajtim me këtë ligj;
 - 1.3. ofrimin e shërbimit në pajtim me programin e miratuar.
2. Çmimet e shërbimeve të ofruara nga shërbimi publik në fushën e bujqësisë përcaktohen në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe mund të bashkëfinancohen nga buxheti i shtetit.

Neni 42 **Programet e shërbimit publik**

1. Programet e shërbimit publik në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural hartohen nga grupi i ekspertëve ndërqeveritar i themeluar nga ministria dhe miratohen nga ministri në pajtim me Planin e zhvillimit kombëtar dhe duhet të specifikojnë:
 - 1.1. llojin dhe vëllimin e shërbimit publik të cilin e ofron ky shërbim;
 - 1.2. mënyrën, procedurën dhe dinamikën e realizimit të shërbimit publik.

Neni 43 **Mbikëqyrja e shërbimit publik**

1. Mbikëqyrjen teknike dhe profesionale për ofrimin e shërbimit publik e bën ministria, e cila mund ta kontraktojë subjektin tjetër për realizimin e mbikëqyrjes teknike.
2. Mbikëqyrjen teknike dhe profesionale, në rastin e kontraktimit publik, e bëjnë personat të cilët janë të kontraktuar për ushtrimin e kontrollit në fushën specifike të shërbimit publik.
3. Ministria me akt nënligjor i përcakton kriteret që zbatohen dhe që kërkohen për kualifikimin profesional të mbikëqyrjes.

KAPITULLI XII **MBIKËQYRJA ADMINISTRATIVE DHE INSPEKTIMI**

Neni 44 **Mbikëqyrja administrative dhe inspektimi nga Ministria**

1. Ministria kryen mbikëqyrjen administrative të zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ai si dhe mbikëqyrjen e institucioneve të tjera të përfshira në zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara me këtë ligj.
2. Ministria kryen kontrollin inspektues për zbatimin e masave të përcaktuara me këtë ligj.
3. Inspektimet e masave të përcaktuara me këtë ligj i kryejnë inspektorët e bujqësisë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 45 **Kontrolli administrativ dhe kontrolli në terren nga Ministria**

1. Ministria kryen kontrollin administrativ dhe kontrollin në terren për të gjitha masat dhe rregullat

për të cilat është përgjegjëse në bazë të akteve nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj.

2. Kontrolli administrativ nga paragrafi 1 i këtij neni përfshinë edhe kontrollimin e konformitetit dhe pajtueshmërisë së aplikacioneve për masa mbështetëse bujqësore siç përcaktohen në këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në pajtim me këtë ligj.

3. Me qëllim të vërtetimit të fakteve dhe rrethanave relevante për vendosjen për dhënien e mbështetjes publike në kuadër të masave të caktuara ose vendimit të caktuar për shfrytëzimin e parashikuar të mbështetjes publike të kontraktuar dhe pagesës, është e domosdoshme që të kryhet kontrolli në terren.

4. Kontrollin në terren nga paragrafi 1 i këtij neni e kryejnë kontrollorët e terrenit të cilët janë të autorizuar nga ministria dhe janë punonjës të ministrisë të cilët kanë autoritetin publik për të kryer kontrollin në terren për të cilin hartojnë raport.

5. Ministria me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe procedurat e kontrollit administrativ dhe kontrollit në terren nga ana e AZhB-së si dhe vlerësimit dhe analizës së rrezikut.

Neni 46 **Detyrat e inspektorëve bujqësor**

1. Në kryerjen e detyrave të tyre, inspektorët bujqësor janë të autorizuar të:

- 1.1. kërkojnë ekzekutimin e aktiviteteve të veçanta brenda një afati të caktuar;
- 1.2. njoftojnë institucionet kompetente për shkeljet e mundshme të ligjit, të identifikuar gjatë kontrollit inspektues;
- 1.3. urdhërojnë masa sigurie në rast rreziku për jetën dhe shëndetin e njerëzve ose interesave të tjera publike;
- 1.4. informojnë institucionet e tjera nëse situata kërkon zbatimin e masave për të cilat janë të autorizuar këto institucione;
- 1.5. ndërmarrin masa apo aktivitete të tjera në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

Neni 47 **Ankesat**

1. Kundër raportit të kontrollit pala mund të ushtroj ankesë pas njoftimit me akt administrativ nga AZhB.

2. Ankesa kundër vendimit të inspektorit nuk e shtyn ekzekutimin e tij.

3. Komisioni i ankesave, i themeluar nga Ministria, vendosë në lidhje me ankesat nga paragrafi 1 i këtij neni.

4. Rishqyrtimi dhe rivendosja e ankesave nga ky nen bëhet sipas kriterëve dhe procedurave administrative të përcaktuara sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 48 **Detyrimet e personave nën inspektim**

1. Personat fizik dhe juridik nën inspektim mundësojnë inspektimin dhe kontrollin në terren nga

ana e inspektorëve dhe kontrolluesëve si dhe ofrojnë informacione dhe të dhëna të kërkuara.

2. Personat fizik dhe juridik nga paragrafi 1 i këtij neni duhet t'ia paraqesin inspektorit dhe kontrolluesit informacionin dhe dokumentet e nevojshme për inspektimin dhe kontrollin në terren në afatin e kërkuar.

KAPITULLI XIII PARTNERITETI SOCIAL DHE EKONOMIK NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Neni 49

Partnerët social dhe ekonomik në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Për nevojat e planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural, ministria krijon një partneritet me partnerë social dhe ekonomik nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

2. Partneriteti nga paragrafi 1 i këtij neni realizohet përmes këtyre organeve:

2.1. Këshilli ndërministror dhe ndërsektorial për bujqësi dhe zhvillim rural;

2.2. Grupet e përhershme nësektoriale;

2.3. Rrjeti kombëtar për zhvillim rural; dhe

2.4. Komiteti për monitorimin e Programit për bujqësi dhe zhvillim rural.

3. Ministria e mbështetë punën e organeve ndërsektoriale sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Ministria me akt nënligjor e përcakton mënyrën, formën e themelimit, rolin dhe përbërjen e grupeve të përhershme nësektoriale.

Neni 50

Këshilli ndërministror dhe ndërsektorial për bujqësi dhe zhvillim rural

1. Qeveria, me propozimin e ministrit të Ministrisë, formon këshillin ndërministrorë dhe ndërsektorial për bujqësi dhe zhvillim rural.

2. Këshilli do të funksionojë si një mekanizëm koordinues në mes institucioneve dhe partnerëve social dhe ekonomik për politikat e bujqësisë dhe zhvillimit rural, dhe do të:

2.1. sigurojë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet Ministrisë, ministrive të tjera pjesëmarrëse në këtë Komitet dhe partnerëve social dhe ekonomik të përfshirë në zbatimin e masave dhe instrumenteve të politikës për zhvillimin bujqësor dhe rural, me qëllim të arritjes së një koncenzusi në lidhje me çështje të caktuara që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural, dhe veçanërisht çështjet që lidhen me politikat e strukturimit të tregjeve bujqësore;

2.2. miratoj programet vjetore të grupeve të punës nësektoriale dhe programet për ndihmë teknike që janë në interes të disa produkteve bujqësore ose të një grupi produkteve;

2.3. ndjekë analizën e kushteve dhe rekomandimeve të institucioneve arsimore dhe shkencore, analizën për zbatimin e politikave në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural; dhe

2.4. kryejë detyra të tjera në lidhje me planifikimin dhe realizimin e objektivave për bujqësi

dhe zhvillim rural.

3. Këshilli miraton një rregullore të punës.
4. Këshilli mban mbledhje të rregullta të paktën një (1) herë në vit.

Neni 51 **Anëtarësia e Këshillit për bujqësi dhe zhvillim rural**

1. Këshillin e përbëjnë:
 - 1.1. Ministria;
 - 1.2. Ministria përkatëse për Financa;
 - 1.3. Ministria përkatëse e Tregtisë;
 - 1.4. Ministria përkatëse e Ekonomisë;
 - 1.5. Ministria përkatëse e Mjedisit,
 - 1.6. Ministria përkatëse e Infrastrukturës;
 - 1.7. kryesuesit e grupeve të përhershme nënsektoriale;
 - 1.8. një (1) përfaqësues nga secila prej tri (3) shoqatave më të mëdha kombëtare të prodhuesëve bujqësor;
 - 1.9. një (1) përfaqësues nga secila nga dy shoqatat më të mëdha të përpunuesëve;
 - 1.10. një (1) përfaqësues nga secila Dhomë e tregtisë;
 - 1.11. një (1) përfaqësues nga secili institucion i arsimit të lartë dhe shkencor në fushën e bujqësisë;
 - 1.12. një (1) përfaqësues nga shoqatat e konsumatorëve;
 - 1.13. një (1) përfaqësues nga Asociacioni i komunave të Kosovës;
 - 1.14. një (1) përfaqësues nga shoqatat për mbrojtjen e ambientit.
2. Këshillin e drejton Ministri.
3. Anëtarët e Këshillit nga paragrafi 1, nënparagrafët 1.7 dhe 1.8 të këtij neni detyrimisht janë përfaqësues të shoqatave të regjistruara në ministri, sipas nenit 52 të këtij ligji.
4. Ministria ushtron funksionin e Sekretariatit të Këshillit.

Neni 52 **Regjistrimi i partnerëve socio-ekonomik**

1. Regjistrat e partnerëve social dhe ekonomik mbahen për partnerët që kanë krijuar dhe kanë arritur partneritet me ministrinë.
2. Partnerët social dhe ekonomik për të cilët mbahen shënimet në ministri janë:
 - 2.1. partnerët social - shoqatat e qytetarëve të krijuara për përmirësimin e interesit

shoqëror në këto fusha:

- 2.1.1. mbrojtja e mjedisit, agro-ekologjisë dhe agrobiznesit;
- 2.1.2. mbrojtja e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe tradicionale të zonave rurale;
- 2.1.3. mbrojtja e interesave dhe roli i prodhuesëve të rinj bujqësor ose grave - prodhuese bujqësore;
- 2.1.4. promovimi i rolit të grave në procesin e zhvillimit të bujqësisë në zonat rurale;
- 2.1.5. mbrojtja e interesave dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve në zonat rurale; dhe
- 2.1.6. mbrojtja e interesave të punëtorëve në fushën e prodhimit bujqësor.

2.2. partnerët ekonomik - shoqatat e qytetarëve të krijuara për mbrojtjen e interesit shoqëror në këto fusha:

- 2.2.1. shoqata të prodhuesve bujqësor të themeluara për mbrojtjen e interesave tregtare të prodhuesëve bujqësor;
- 2.2.2. shoqata të përpunuesëve të produkteve bujqësore ose tregtarëve me produkte bujqësore;
- 2.2.3. kooperativat bujqësore dhe sindikatat në fushën e prodhimit bujqësor;
- 2.2.4. dhomat e tregtisë në fushën e veprimtarive bujqësore dhe përpunuesit e produkteve bujqësore.

3. Mënyra e regjistrimit dhe fshirjes në regjistrin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni dhe dokumentet e kërkuara për këto veprime përcaktohen me akt nënligjor nga ministria.

4. Fushat nga paragrafi 2 i këtij neni detyrimisht duhet të jenë të cekura në statutin e shoqatës.

KAPITULLI XIV NDËSHKIMET DHE SANKSIONET

Neni 53 Ndëshkimet

1. Përfituesi i masave të politikave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji do të ndëshkohet nëse:

- 1.1. nuk i ka përmbushur obligimet e përcaktuara në kontratë;
- 1.2. nuk i ka zbatuar qëllimet e përcaktuara në projekt;
- 1.3. ka paraqitur të dhëna të rrejshme;
- 1.4. ka mospërputhshmëri të njësive bujqësore të deklaruara dhe të verifikuara gjatë kontrollës administrative dhe kontrollës në terren;
- 1.5. ka penguar kontrollin dhe inspektimin zyrtar.

2. Në rast të cilësdo nga parregullsitë nga paragrafi 1 i këtij neni dhe në përputhje me paragrafin 4 të nenit 17 të këtij ligji, e tërë shuma e përkrahjes nga secila masë e politikës nga neni 10 i këtij ligji duhet të kthehet në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe përfituesi do t'i nënshtrohet

procedurave ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

3. Përveç obligimit të kthimit të pagesës sipas nenit 17, paragrafi 4 i këtij ligji, përfituesi përjashtohet nga të gjitha masat e politikës sipas nenit 10 të këtij ligji për tri (3) vite me vendim të Ministrisë, nëse ekziston së paku njëra nga parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni.

4. Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendura, Ministria do ta informoj palën për shkelje të kontratës dhe duhet të filloj procedurat ligjore sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 54

Sanksioni kundërvajtës me gjobë

1. Përveç ndëshkimeve të përcaktuara në nenin 53 të këtij ligji, në rast se përfituesi i masave të politikave vepron në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji dënohet me gjobë dhe atë:

1.1. personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, dënohet me gjobë jo më pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo më shumë se dy mijë (2.000) euro;

1.2. personi fizik që ushtron biznes individual, dënohet me gjobë jo më pak se dyqind (200) euro, dhe jo më shumë se pesëmijë (5.000) euro;

1.3. personi juridik dënohet me gjobë jo më pak se pesëqind (500) euro, dhe jo më shumë se njëzetmijë (20.000) euro.

2. Në rast se përfituesi i masave të politikave vepron në kundërshtim me nenet 44 dhe 45 të këtij ligji dënohet me gjobë dhe atë:

2.1. personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, dënohet me gjobë jo më pak se dhjetë (10) euro, dhe jo më shumë se njëqind (100) euro;

2.2. personi fizik që ushtron biznes individual, dënohet me gjobë jo më pak se tridhjetë (30) euro, dhe jo më shumë se dyqindpesëdhjetë (250) euro;

2.3. personi juridik dënohet me gjobë jo më pak se njëqind (100) euro, dhe jo më shumë se njëmijepesëqind (1.500) euro.

3. Përjashtimisht nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni për kundërvajtjet e kryera me qëllim të realizimit të përfitimit personal me të cilin është realizuar dobia pasurore, kryerësi mund të dënohet më së shumti deri në shumën e dyfishuar të paraparë me sanksion kundërvajtës me gjobë për atë kundërvajtje.

Neni 55

Të hyrat

1. Të gjitha të hyrat që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Buxheti për zbatimin e masave të politikave të parapara me këtë ligj duhet të jetë në pajtim me ndarjet buxhetore për vitin fiskal.

**KAPITULLI XV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 56
Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxjerrën brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 57
Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

**Neni 58
Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr.08/L-072
8 mars 2023**

Shpallur me dekretin Nr. DL-56/2023, datë 24.03.2023 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu